

**BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK BELSH**

Belsh më 25/ 06/ 2026

**PROCES – VERBAL
“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 25.06.2026”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

Janë prezent në mbledhje 12 këshilltarë:

1. Kujtim Dervishi
2. Avni Shtylla
3. Erion Gjoshi
4. Bujar Blloku
5. Nexhip Elezi
6. Naime Ibrahim
7. Sami Uruçi
8. Aurjola Bezati
9. Enkeleda Kullolli
10. Fadil Zdrava
11. Aleksander Idrizi
12. Gezim Gjoshi

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen. Kanë ardhur dhe 2 projekt vendime të reja për 2 marrëveshje që duan miratimin e këshillit.
- Hidhet në votim propozimi për 2 shtesat dhe miratohet me 12 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.1 e rendit të ditës për miratimin e marrëveshjes midis Bashkisë Belsh dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Prezanton p/vendimin Anxhelina Qypi.
- Aurjola B: A ka afat kohor për zbatimin e marrëveshjes?
- A.Qypi: Jo, nuk ka një afat në marrëveshje.
- Kujtim D: Sa është vlera e investimit?
- A.Qypi : Vlera e projektit do të financohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FZHSH).
- Kujtim D: A çënohet pylli apo sipërfaqja ujore?
- A.Qypi: Jo, nuk preket as pylli as sipërfaqja ujore.
- Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 12 vota pro,
- Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Belsh dhe shoqërisë AROI shpk.

- Mbron Anxhelina Qypi p/vendimin dhe e prezanton për këshilltarët.
- A.Qypi : Projekti do të zhvillohet në ato toka të degraduara dhe do të ripyllëzohen.
- Sami Uruçi: Mendoj që duhet të kishit ardhur një hartë të tokave që preken.
- Alban Nipolli: Në fillim negociohet pastaj përcaktohen parcelat që do të preken.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro pika nr.2 e rendit të ditës.
- Kalojmë te pika nr.3: P/Vendim për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkise Belsh dhe FZSH për "Qendra Rajonale e Valorizimit të Vajit të Ullirit"
- Prezanton A.Qypi p/vendimin.
- Kujtim D: Çfarë funksioni kanë objektet?
- A. Qypi: Për momentin nuk kanë funksion.
- Hidhet në votim dhe miratohet pika nr.3 me 12 vota pro.
- Kalojmë te të ndryshmet për ndihmë financiare për 2 kërkesat nga Zhaneta Dervishi dhe Ferdinand Zdrava.
- A.Nipolli : Nuk ka fond të dedikuar për ndihmë financiare në buxhetin 2026.
- Meqënëse nuk ka fond për ndihmë financiare , nuk diskutohen 2 kërkesat e banorëve për ndihmë financiare,përkatesisht kërkesa e Zh.Dervishi dhe F.Zdrava.
- Mbyllet mbledhja me 3 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA

